



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE  
SENATI AKADEMIK

Nr. 227/13 Prot.

Vlorë, më 29.01.2020

**VENDIM**

**Nr. 52, datë 29.01.2020**

**PËR**

**RIORGANIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT "BACHELOR" NË "DREJTËSI" NË PROGRAM TË INTEGRUAR TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË, "MASTER I SHKENCAVE" NË "DREJTËSI", NË UNIVERSITETIN 'ISMAIL QEMALI', VLORE**

Mbështetur në shkronjën **b** të pikës **3** në nenin **75**, nenin **82**, shkronjën **dh** të pikës **1** në nenin **38** në ligjin Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Udhëzimin nr. 1, datë 14.01. 2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësave kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë", VKM nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", Senati Akademik në mbledhjen e datës 29.01.2020

**VENDOSI:**

1. Të miratojë propozimin e Departamentit të Drejtësisë me nr. 348 prot., datë 12.11.2019 për riorganizim të programit "Bachelor" në "Drejtësi" në program të integruar të ciklit të dytë të studimeve "Master i shkencave" në "Drejtësi" në përshtatje me ndryshimet ligjore që parashikojnë riorganizimin e këtij programi studimi nga program i ciklit të parë të studimeve me 180 kredite në program të integruar studimi të ciklit të dytë me 300 kredite.
2. Ky program studimi parashikohet të zbatohet për vitin akademik 2020-2021 pas urdhrimit të miratimit nga MASR.
3. Vendimi i përcillet për miratim të mëtejshëm Bordit të Administrimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I SENATIT AKADEMIK**

**Prof. Dr. Roland ZISI**

